

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Jam çlirimtar"/ Nga thirrjet para kryeministrit të marshimi në rrugët e Tiranës, çfarë ndodhi në protestë në 108-të
ADRESA	https://tpz.al/jam-clirimtar-nga-thirrjet-para-kryeministrit-te-marshimi-ne-rruget-e-ti-ranes-cfare-ndodhi-ne-protesten-e-108-te-i333023
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:56:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	00e283a25c86d5841eeebf5e6e2a03d2c69be42415d76ade1ce0bd4e2820d6ee
TEKSTI	efe6ff8bdd678d95bf894f0a09c09e2e7c39bf28c49b1ad805a5581ec79516ac
PAMJA	6ee6c8e4b863241b20e5511f7b43bb119f50f613d4acfa2c7e8103533427728d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b02d11c938329628f7cce868fa2596d7b81e2748bd575514e3685ba98e2fa4f7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b02d11c938329628f7cce868fa2596d7b81e2748bd575514e3685ba98e2fa4f7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

19:09 Neutralizohet vatra e zjarrit në fshatin Andon Poçi të Gjirokastrës • 18:35 Panik në Stamboll/ Të shtëna me armë në një dyqan, 3 persona humbin jetën • 17:37 Ak

AKTUALITET, 15 SEPTEMBER 2026, 21:40

"Jam çlirimtar"/ Nga thirrjet para kryeministrit të marshimi në rrugët e Tiranës, çfarë ndodhi në protestën e 108-të

tpz.al TPZ



Ka vijuar këtë të hënë protesta e 108-të kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama në Tiranë. Tubimi nisi në sheshin "Skënderbej", ndërsa pas përfundimit të fjalimeve të aktivistëve, qytetarët vijuan me marshimin në rrugët e kryeqytetit.

Gjatë marshimit u dëgjuan thirrje si: "Shqipëria kërkon revolucion", "Shqipëria po bën revolucion", "Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria", "Ju erdhi fundi", "Arrestoni Ramën" dhe "Dorëheqje".

Mesazhet e protestuesve përmes pankartave

Në protestën e 108-të nuk kanë munguar pankartat me mesazhe politike dhe ironizuese ndaj qeverisë dhe zhvillimeve të fundit.

"108 na bllokoi online. Na gjen në shesh", shkruhej në njërin prej tyre.



ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucionari" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [klike këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super



Një tjetër pankartë i drejtohej kryeministrit Rama me mesazhin: "Rama jashtë – problem me shqiptarët. Kur popullit i fshihesh, me ç'fytirë pushtetit i ngjitesh?"

Kritika janë përcjellë edhe ndaj sistemit të drejtësisë dhe debatit për pagat e gjyqtarëve dhe magistratëve. "Pagat e gjyqtarëve – shfaqje e qëllimshme, skandalet e Ramës – heshtje e dhimbshme!", shkruhej në një prej pankartave.



Thirrje për vijimin e protestave

Gjatë fjalimeve para Kryeministrit, aktivisti Arben Kola bëri thirrje për vijimin e protestave dhe rritjen e presionit publik ndaj qeverisë. Ai kërkoi që SPAK-u të vijojë me hetimet dhe arrestimet e zyrtarëve të lartë.

"Veliaj në qeli dhe shqiptarët të lirë. Radhën e ka Rama. Ju ftoj çdo ditë në shesh të rrisim presionin popullor", u shpreh Kola.

Ai deklaroi gjithashtu se SPAK-u duhet të vijojë me arrestimet, duke e cilësuar këtë institucion si të rëndësishëm për atë që ai e konsideron çlirimin e vendit nga kapja e mafies.

Kola njoftoi edhe për një tjetër protestë të paralajmëruar para Parlamentit. Sipas tij, Kuvendi pritet të mblidhet të enjten në një seancë urgjente për shqyrtimin e pesë projektligjeve, të cilat ai i akuzoi se synojnë, sipas tij, të dëmtojnë interesat e qytetarëve.

"Ditën e enjte parlamenti i krimit rimblidhet me urgjencë për të kaluar 5 ligje që kanë për grabitjen e shqiptarëve. Ndaj atje janë kriminelët, tradhtarët. Ditën e enjte ora 10: të gjithë te Parlamenti", deklaroi ai.

Kritika për bujqësinë dhe subvencionet

Në fjalimet e protestuesve u ngritën edhe çështje që lidhen me gjendjen e bujqësisë.

Anëtarja e Dhomës Britanike të Drejtësisë, Silvana Hoxha Xhaferri, deklaroi se bujqësia në Shqipëri ndodhet, sipas saj, në gjendje të rëndë. Ajo akuzoi qeverinë se subvencionet e Bashkimit Evropian përfundojnë te njerëz pranë kryeministrit Edi Rama.

"Bujqësia është në ditën e vet më të zezë sot. Bujqësia sot nuk ka subvencione, sepse vidhen. Edi Rama kërkon pranë vetes vetëm njerëz, që kërkojnë të vjedhin", tha ajo.

Hoxha Xhaferri kërkoi gjithashtu që Edi Rama dhe Sali Berisha të përballen me drejtësinë, ndërsa bëri thirrje për vijimin e protestave.

Ajo përmendi edhe fermerët në disa qytete, duke pretenduar se situata e krijuar në sektor ka sjellë pasoja për prodhuesit vendas.

Thirrje për bashkimin e studentëve

Një studente që mori fjalën në protestë bëri thirrje për bashkimin e qytetarëve dhe veçanërisht të studentëve në protestë.

"Bashkohuni sa më shpejt. Ne do vazhdojmë dhe ju presim këtu në shesh. Bashkohuni studentë, kombi na thërret dhe nuk na ndal më asgjë. Nuk ikim nga ky shesh", u shpreh ajo.

Studentja iu referua gjithashtu zhvillimeve të ditës dhe largimit të Taulant Ballës nga protesta, duke deklaruar se qytetarët duhet të vijnë qëndrimin në shesh.

Akuza të tjera gjatë protestës

Një tjetër protestues, i cili u prezantua si babai i një personi të arrestuar nga policia për pjesëmarrje në protesta, ngriti akuza të forta ndaj kryeministrit dhe institucioneve shtetërore.

Ai deklaroi se qeveria ka dëmtuar, sipas tij, policinë dhe drejtësinë, ndërsa kritikoi edhe qëndrimin e ndërkombëtarëve ndaj qeverisë shqiptare.

"Rama mori përsipër të na shuante si komb. Ka njerëz policinë dhe drejtësinë. Nuk ka policë të mirë, nuk ka drejtësi", u shpreh protestuesi.

Ai tha gjithashtu se përgjegjësia për situatën, sipas tij, nuk është vetëm e qeverisë, por edhe e aktorëve ndërkombëtarë që e mbështesin atë.

Protesta vijon me marshim

Pas përfundimit të fjalimeve para Kryeministrit, qytetarët nisën marshimin në rrugët e Tiranës, duke mbajtur flamuj kombëtarë dhe duke përsëritur thirrjet kundër qeverisë.

"Shqipëria kërkon revolucion", "Ju erdhi fundi", "Arrestoni Ramën" dhe "Nuk shitet Shqipëria, shitet qeveria" ishin disa prej thirrjeve të dëguara gjatë marshimit.





Protesta e sotme shënon ditën e 108-të të revoltës kundër qeverisë. Pjesëmarrësit deklarojnë se do ta vijojnë qëndresën edhe në ditët në vazhdim, duke e mbajtur presionin qytetar ndaj qeverisë deri në realizimin e kërkesës së tyre kryesore për largimin e Edi Ramës.





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.